



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion dhe Gjyqësi

Mbledhja nr. 02

Prishtinë, më 25 janar 2010, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi

Në mbledhje morën pjesë: Bahri Hyseni - kryetar, Bajram Kosumi, Adem Hajdaraj, Selvije Halimi, Ramadan Gashi, Ibrahim Makolli, Adem Salihaj, Vladimir Todoroviq, Mufera Şinik dhe Kolë Berisha.

Mungoi: Armend Zemaj, për shkak të udhëtimit zyrtar.

Pjesëmarrës të tjerë: Shqipe Arifaj - Asociacioni i Komunave të Kosovës, Lumnije Muarti –ZPRK, Saranda Stublla - Lëvizja FOL, Isuf Zeina - KDI, Blerta Bejtullahu - ICO, Rrezarta Ahmeti - KDI dhe Visar Krasniqi – Zyra e Komisioneve të Kuvendit.

Nga Stafi i Komisionit: Idriz Tahiri, Fehmi Hyseni dhe Sulltane Gashi.

Mbledhjen e kryesoi: Bahri Hyseni, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky

Rend i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjes së 18 janarit 2010,
3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës,
4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,
5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Gazetën Zyrtare,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për vitin 2009,
7. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të 18 janarit 2010

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 18 janar 2010, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Ministrisë së Drejtësisë për plotësimin dhe ndryshimin e Komisionit për dhënien e Provimit të Jurisprudencës

Kryetari - Tha se në mbledhjen e kaluar e kemi lënë hapur mundësinë të bëjmë edhe një përpjekje të fundit që të shikohet mundësia e një zgjidhje eventuale, mirëpo nuk kemi hasur në mirëkuptim nga ministrja. Në vazhdim ceku se kam takuar edhe kryetarin e Kuvendit dhe kam bërë përpjekje që të jem në kontakt me ministren, mirëpo ajo mban të njëjtin qëndrim. Ne, krahas rekomandimeve rreth kandidateve, mund të kërkojmë nga Kuvendi që të nxjerrë vendim, me të cilin do të kërkojë nga Ministria e Drejtësisë që të fillojë organizimi rreth mbajtjes së provimit të jurisprudencës me përbërjen ekzistuese. Sepse ligji nuk e thotë që nëse nuk janë 13 anëtarët e Komisionit nuk mund të mbahet provimi i jurisprudencës. Prandaj nëse keni ndonjë propozim, hapi debat lidhur me këtë pikë.

Adem Hajdaraj - Në diskutimin e tij tha se meqë Kuvendi e ka refuzuar kandidatin Ruzhdi Berisha dhe kemi vendimin e Kuvendit për këtë kandidat, të mos e rekomandojmë fare. Andaj mendoj që vetëm dy kandidatët e tjerë të propozuar mund t'i rekomandohen Kuvendit.

Bajram Kosumi - Duke u ndërlidhur me parafolësit tha se do të duhej që Kuvendit t'i propozojmë që kandidatin Ruzhdi Berisha të mos e votoi, sepse dy herë nuk është votuar në seancë. Rreth propozimit të kërkojmë nga Ministria e Drejtësisë që të fillojë organizimin për mbajtjen e provimit të jurisprudencës, duhet shikuar se sa ne mundemi të kërkojmë një gjë të tillë, sepse është çështje e përgjegjësive. Po ashtu kjo është një çështje jashtë asaj çka ne po bisedojmë. Kërkoj të dalim në një materie tjetër dhe do të na dalin kërkesa të tjera në seancë. Ne, si Komision, vetëm mund t'i rekomandojmë Ministrisë së Drejtësisë që të fillojë organizimin për mbajtjen e provimit të jurisprudencës, nëse nuk e thërret brenda afatit të caktuar atëherë ne mund ta thërrasim në interpelancë.

Pas një debati që u zhvillua Komisioni unanimisht u pajtua që Kuvendit të Kosovës t'ia paraqesë këtë:

REKOMANDIM

1. Të emërohet Asllan Bilalli, anëtar i Komisionit për Provimin e Jurisprudencës për lëndën: E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut.
2. Të emërohet Remzije Istrefi, zëvendësanëtare e Komisionit, për lëndën: E drejta ndërkombëtare dhe evropiane për të drejtat e njeriut.
3. Të refuzohet Ruzhdi Berisha i propozuar për anëtar të Komisionit për lëndët civile, i refuzuar dy herë me vendimet e Kuvendit të Kosovës nr. 03-V- 119, të datës 11 qershor 2009 dhe nr. 03-V-211 të datës 02 nëntor 2009.
4. Të kërkohet nga Ministria e Drejtësisë që në afat prej dhjetë ditësh ta organizojë mbajtjen e provimit të jurisprudencës me përbërjen ekzistuese të Komisionit për Provimin Jurisprudencës.

4. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale

Kryetari i njoftoi anëtarët me agjendën legislative të Qeverisë së Kosovës duke i precizuar ligjet që do t'i ketë në shqyrtim gjatë këtij viti. Do të shikohet mundësia që Komisioni të ketë përkrahje, qoftë me ekspertë ose në forma të tjera që do t'i ofrohen si mbështetje.

Meqë nuk pati vërejtje rreth këtij projektligji kryetari konstatoi se Komisioni miratoi në parim Projektligjin për ekzekutimin e sanksioneve penale dhe i njëjti procedohet për shqyrtim të mëtejme.

5. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Gazetën Zyrtare

Miratohet në parim Projektligji për Gazetën Zyrtare dhe i njëjti procedohet për shqyrtim të mëtejme.

6. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të punës së Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për vitin 2009

Kryetari – E prezantoi Raportin e punës së Komisionit për vitin 2009, i cili është një raport që pasqyron punën e Komisionit dhe konsideroj se është gjithëpërfshirës, andaj nëse keni vërejtje eventuale mund t'i paraqitni ato.

Selviqe Halimi - Lidhur me Raportin e punës së Komisionit tha se a do të duhej të përfshihen në raport edhe takimet e kryetarit të Komisionit?

Ibrahim Makolli - Duke folur për Raportin ju referua Rregullores së punës të Kuvendit, rregullës 53.3. , ministritë përkatëse i raportojnë Komisionit Funkcional, pa kërkesë së

paku një herë në vit. Deri me sot asnjë ministri nuk ka raportuar, kjo do të duhej të futej në Raportin e punës së Komisionit. Është detyrim i Komisionit me Rregulloren e punës që një herë në vit të raportojnë me shkrim dhe me gojë në Kuvend.

Kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Raporti i punës së Komisionit për vitin 2009, me vërejtjet që në raport të përfshihen edhe takimet e kryetarit të Komisionit.

7. Të ndryshme

Kryetari - I njoftoi anëtarët e Komisionit me përfundimin e Kryesisë, me të cilin detyrohen komisionet që deri më datën 29 janar 2010 ta përfundojnë Planin e punës.

Ju e keni një draft para vetes, nëse keni diçka që nuk është përfshirë, e do të duhej të ishte pjesë e tij mund ta paraqitni.

Në vazhdim i njoftoi edhe me shumën e buxhetit që e ka në dispozicion Komisioni, që gjatë këtij viti do të planifikohet se si të menaxhohet.

Adem Salihaj - Propozoj që, si Komision, të bëjmë një plan financiar që të planifikohet buxheti dhe të dihet me kohë destinimi i tyre.

Meqë nuk pati vërejtje rreth Planit të punës kryetari konstatoi se Komisioni në mënyrë unanime nxori këtë:

PËRFUNDIM

Miratohet Plani i punës së Komisionit për vitin 2010, pjesë e tij do të jetë edhe plani financiar dedikuar për Komisionin.

Mbledhja përfundoi në orën 14:15

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Bahri Hyseni

